



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L -266

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GARANCISË PËR
LINJËN KREDITORE PËR FONDIN E SIGURIMEVE TË
DEPOZITAVE TË KOSOVËS NDËRMJET REPUBLIKËS SË
KOSOVËS DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GARANCISË PËR
LINJËN KREDITORE PËR FONDIN E SIGURIMEVE TË
DEPOZITAVE TË KOSOVËS NDËRMJET REPUBLIKËS SË
KOSOVËS DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM**

Neni 1

Qëllimi i ligjit

1. Ky ligj ka për qëllim ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë për Linjën Kreditore për Fondin e Sigurimeve të Depozitave të Kosovës ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.
2. Nëpërmjet këtij ligjit ratifikohet Marrëveshja e Garancisë Shtetërore për garantimin e Linjës Kreditore nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në shumë prej dhjetë (10) milion Euro, ku qëllimi i Linjës Kreditore është rritja graduale e shumës së garantuar të depozitave nga dy (2) mijë Euro deri në tre (3) mijë Euro, dhe mundësimi i qasjes në fonde, në rast të dështimit të ndonjë banke.

Neni 2
Ratifikimi i marrëveshjes

Ratifikohet Marrëveshja e Garancisë për Linjën Kreditore për Fondin e Sigurimeve të Depozitave të Kosovës ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, e nënshkruar më 19 dhjetor 2013 në Prishtinë.

Neni 3
Dokumentet e bashkëngjitura

1. Në Aneksin 1 të këtij ligji është e bashkëngjitur Marrëveshja e Garancisë për Linjën Kreditore për Fondin e Sigurimeve të Depozitave të Kosovës ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, e nënshkruar më 19 dhjetor 2013, në Prishtinë.

2. Në Aneksin 2 të këtij ligji është e bashkëngjitur Marrëveshja për Hua – Linja Kreditore për Fondin e Sigurimeve të Depozitave në Kosovë, e nënshkruar mes të Fondit për Sigurimin e Depozitave të Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, më 19 dhjetor 2013, në Prishtinë.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L -266
10 prill 2014

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI

(Numri i operimit 45446)
Versioni për ekzekutim

MARRËVESHJA E GARANCISË
PËR LINJËN KREDITORE PËR FONDIN E SIGURIMEVE TË DEPOZITAVE NË
KOSOVË

ndërmjet

REPUBLIKËS SË KOSOVËS
(Përfaqësuar nga Ministri i Financave)

dhe

BANKËS EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Data 19 Dhjetor 2013

TABELA E PËRMBAJTJES

NENI I - TERMAT DHE KUSHTET STANDARDE; PËRKUFIZIMET	1
Paragrafi 1.01. Përfshirja e Termave dhe Kushteve Standarde	1
Paragrafi 1.02. Përkufizimet.....	1
Paragrafi 1.03. Interpretimi	2
NENI II – GARANCIA DHE PROCEDURAT	2
Paragrafi 2.01. Garancia	2
Paragrafi 2.02. Procedurat	2
NENI VII - TË NDRYSHME	2
Paragrafi 3.01. Njoftime	2
Paragrafi 3.02. Opinioni ligjor.....	3

MARRËVESHJA E GARANCISË

MARRËVESHJA E GARANCISË më datë 19 Dhjetor 2013 mes **REPUBLIKËS SË KOSOVËS** (“Garantuesi”) dhe **BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM** (“Banka”) (“Marrëveshja e Garancisë”).

PARATHËNIE

NDONËSE, Garantuesi dhe Fondi i Sigurimit të Depozitave në Kosovë kanë kërkuar asistencë nga Banka për financim të një pjese të projektit;

NDONËSE, në pajtim me marrëveshjen për hua të kësaj date ndërmjet Fondit për Sigurimin e Depozitave të Kosovës si Huamarrës dhe Bankës (“Marrëveshja e huasë”, siç përcaktohet në Termat dhe Kushtet Standarde), Banka ka rënë dakord të bëjë një linjë kreditore për Huamarrësin në shumë prej 10 milion Euro, që i nënshtrohet termave dhe kushteve të përcaktuara ose të referuara në Marrëveshjen e Huasë, por vetëm me kusht që garantuesi të garantojë për detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huasë, siç parashikohet në këtë Marrëveshje; dhe

NDONËSE, Garantuesi, duke marrë parasysh se Banka hyn në Marrëveshje të Huasë me Huamarrësin, ka rënë dakord për të garantuar detyrimet e Huamarrësit.

SI REZULTAT, TANI, palët bien dakord si më poshtë:

NENI I - TERMAT DHE KUSHTET STANDARDE; PËRKUFIZIMET

Paragrafi 1.01. Përfshirja e Termave dhe Kushteve Standarde

Të gjitha dispozitat e Termave dhe Kushteve Standarde të Bankës së datës 1 dhjetor 2012 janë përfshirë dhe bërë të zbatueshme për këtë Marrëveshje me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishin plotësisht të parapara në këtë dokument, (dispozita të tilla në tekstin e mëtejme quhen “Termat dhe Kushtet Standarde”).

Paragrafi 1.02. Përkufizimet

Të përdorura kudo në këtë Marrëveshje (duke përfshirë Parathënien), nëse nuk bëhet e ditur ndryshe ose konteksti e kërkon ndryshe, termat e përcaktuara në parathënie kanë kuptim përkatës dhënë atyre, termat e përcaktuara në kushtet dhe termat standarde kanë kuptimet përkatëse të dhënë atyre dhe termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

"Përfaqësuesi i autorizuar i
Garantuesit"

nënkupton Ministrin e Financave të Garantuesit.

Paragrafi 1.03. Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, referenca në një nen, paragraf të caktuar, përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, interpretohet si referencë ndaj atij neni, paragrafi të caktuar, të kësaj Marrëveshjeje.

NENI II – GARANCIA DHE PROCEDURAT

Paragrafi 2.01. Garancia

Garantuesi garanton në mënyrë të pakushtëzuar, si i detyruari primar dhe jo si garant i thjesht që pagesa me kohë dhe pagesa përpiktë të çdo dhe të gjitha shumave sipas Marrëveshjes së Huasë, qoftë në maturim të deklaruar, me nxitje ose ndryshe , dhe përfundimi me përpikëri i të gjitha detyrimeve të tjera të Huamarrësit, ashtu siç është përcaktuar në Marrëveshjen e Huasë.

Paragrafi 2.02. Procedurat

(a) Garantuesi konfirmon se ka njohuri për termat dhe kushtet e marrëveshjes së huasë.

(b) Banka bie dakord që çdo kërkesë për pagesë të garantuesit sipas kësaj Marrëveshjeje, ta bëjë me shkrim, dhe kërkesa të tilla për pagesë duhet të specifikojë shumën e papaguar sipas Marrëveshjes së Huasë dhe që duhet të paguhet nga garantuesi, data në të cilën shuma e tillë duhet paguar nga garantuesi, e data është jo më pak se tri ditë pune nga data e njoftimit të kërkesës.

NENI VII - TË NDRYSHME

Paragrafi 3.01. Njoftime

Adresat në vijim janë specifikuar për qëllimet e paragrafit 10.01 të kushteve dhe termave standarde:

Për Garanruesin:

Republika e Kosovës
Ministria e Financave
Sheshi Nëna Terezë, pn
Ndërtesa e Qeverisë
Prishtinë, Kosovë

Në vëmendje të: Ministrit të Financave

Faksi: +381 38 21 31 13

Për Bankën:

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
Londër EC2A 2JN
Mbretëria e Bashkuar

Në vëmendje të: Departamenti i Administratës dhe Operimeve

Faksi: +44-20-7338-6100

Paragrafi 3.02. Opinioni ligjor

Për qëllimet e paragrafit 9.03(b) të termave dhe kushteve standarde, dhe në përputhje me termat e Marrëveshjes së Huas, opinioni ose opinionet ligjore të këshilltarit do të jepen në emër të Garantuesit nga Ministri i Drejtësisë. Forma e një opinioni të tillë është bashkangjitur kësaj Marrëveshjeje.

NE PRANI TË DËSHMITARËVE, palët në këtë Marrëveshje duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, kanë bere që kjo Marrëveshje të nënshkruhet ne katër kopje në Prishtinë, Kosovë, në ditën dhe vitin e shkruar me sipër.

REPUBLIKA E KOSOVËS

Nga: Besim Beqaj
Emri: Besim Beqaj
Titulli: Ministër i Financave

**BANKA EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

Nga:
Emri: Claudio Viezzoli
Titulli: Drejtor për Ballkanin Perëndimor

BASHKËNGJITUR
FORMA E OPINIONIT LIGJOR TË GARANTUESIT

[Logoja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës]
TË KONFIRMOHET NGA MINISTERIA

Banka Evropiane për
Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
Londër EC2A 2JN
Mbretëria e Bashkuar

[Data]

Zonja dhe zotërinj:

Re: Opinioni ligjor për (i) Marrëveshjen për Hua ndërmjet Fondit për Sigurim të Depozitave në Kosovë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, (ii) Marrëveshja e Garancisë nr [] të datës [] (Operimi nr. 44842).

Më [] 2013, Fondi për Sigurim të Depozitave në Kosovë (“**Huamarrësi**”) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“**Banka**”) lidhën një marrëveshje për hua (“**Marrëveshja për hua**”) si dhe Republika e Kosovës (“Shteti”) dhe Banka hyn në marrëveshje të garancisë përmes së cilës Shteti garanton për obligimet e Huamarrësit në favor të Bankës (“**të Garancisë**”).

Në këtë opinion, fjalët dhe shprehjet e përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë do të kenë të njëjtat kuptime edhe këtu.

Në cilësinë time si Ministër i Drejtësisë së Republikës së Kosovës, kam shqyrtuar dhe kam nënshkruar një kopje të Marrëveshjes për Hua dhe të Garancisë si dhe gjithë dokumentacionit tjetër përkatës si dhe kam shqyrtuar Kushtetutën e Kosovës së bashku me ligje të tilla, statute, dokumente dhe çështje të tjera, dhe kam bërë kërkime të tjera të tilla që unë i konsideroj të nevojshme ose të përshtatshme për të dhënë këtë opinion. Bazuar në atë që u tha më sipër, unë jam i mendimit dhe deklaroj, përkatësisht se:

- (a) [sipas Nenit [] të Kushtetutës së Garantuesit, Kryesia është përgjegjëse (me pëlqimin të Komisionet Parlamentare) për negociimin dhe ratifikimin e traktateve ; Neni 3 i Ligjit për procedurat për përmbylljen e Marrëveshjeve ndërkombëtare (Gazeta Zyrtare e Kosovës nr []) parasheh se Presidenca e Kosovës mund të autorizojë Këshillin e Ministrave të Kosovës dhe organet tjera përgjegjëse të Kosovës të përmbyllin një marrëveshje të caktuar ndërkombëtare. Bazuar në nenet [] të ligjit të përmendur, Këshilli i Ministrave

të Kosovës është i autorizuar të lidhë dhe realizoj, përmes institucioneve përgjegjëse, garancinë dhe të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e detyrimit që dalin nga kjo.] ose

- (b) *[nga]shënoni referencën për autorizimin e Qeverisë (ose të personit apo organit tjetër) që shtë dhënë përfaqësuesit të Garantuesit të negociojë dhe nënshkruajë Garancinë në emër të Republikës së Kosovës], Presidencës [apo ndonjë person ose organ tjetër i autorizuar] [], Ministri i [] autorizuar, për të përmbyllur dhe realizuar garancinë në emër të shtetit. Autoriteti i jepet [], për të ndërmarrë veprime të tilla, në emër të shtetit, vazhdon të jetë në fuqi dhe efekt të plotë në kohën e nënshkrimit të marrëveshjeve të përmendura.*
- (c) Në pajtim me dispozitat e neneve [] të Kushtetutës së Shtetit, negociimi dhe ratifikimi i traktateve i nënshtrohet pëlqimit të Qeverisë së Kosovës.
- (d) Në pajtim me dispozitat e neneve [] dhe nenit [] i Kushtetutës së Shtetit, negociimi, realizimi, ofrimi dhe zbatimi i Marrëveshjes së Huasë dhe hyrja në marrëveshje të garancisë kanë marrë pëlqimin nga Qeveria e Kosovës në pajtim me *[Cito ligjin e miratuar ose rregulloren e cila jep pëlqimin për ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë]*.
- (e) Në pajtim me dispozitat e neneve [] të Kushtetutës së Shtetit, negociimi dhe ratifikimi i traktateve i nënshtrohet pëlqimit të Komisionit Parlamentar të Shtetit.
- (f) Në pajtim me dispozitat e neneve [] dhe nenit [] i Kushtetutës së Shtetit, negociimi, realizimi, ofrimi dhe zbatimi i Marrëveshjes së Huasë dhe hyrja në marrëveshje të garancisë kanë marrë pëlqimin nga Kuvendi i Kosovës sipas *[Cito ligjin e miratuar ose rregulloren e cila jep pëlqimin për ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë]*.
- (g) Në pajtim me dispozitat e neneve [] të Kushtetutës së Garantuesit, Marrëveshja e Huasë dhe Marrëveshja e Garancisë janë ratifikuar nga Presidenca më *[shënoni datën]* siç është evidentuar nga *[specifikoni instrumentin e ratifikimit]*
- (h) Në pajtim me dispozitat e Ligjit të Kosovës mbi procedurat për përmbylljen dhe zbatimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare (Gazeta Zyrtare e Kosovës nr []) kërkesa në lidhje me publikimin e njoftimit të realizimit, ofrimit, ratifikimi dhe përfundimit, ose në ndonjë drejtim tjetër, Marrëveshja e huasë dhe Garancisë është përfunduar dhe plotësuar.
- (i) Në pajtim me dispozitat e Ligjit për borxhin publik të Kosovës (Gazeta Zyrtare nr []), kërkesat në lidhje me realizimin, ofrimin, dhe përfundimin e garancisë janë kompletuar dhe plotësuar.
- (j) Të gjitha aktet, kushtet dhe autorizimet të cilat duhet të ekzekutohen, plotësohen dhe kryhen në mënyrë që t'i mundësojnë Kosovës, si garantues dhe Fondit për Sigurimin e Depozitave të Kosovës , si Huamarrësi të hynë në mënyrë të ligjshme, të ushtrorë të drejtat e tyre, dhe detyrimet e përcaktuara, për Marrëveshjen e Garancisë dhe respektivisht Huasë, janë përmbushur dhe kryer në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.

- (k) Obligimet e secilit, shtetit si garantues, Fondit për Sigurimin e Depozitave si Huamarrës, siç përcaktohet në Marrëveshjen e Garancisë dhe respektivisht Huasë, përbëjnë detyrime ligjore, të vlefshme dhe detyruese për garantuesin dhe huamarrësin dhe janë të zbatueshme në pajtim me termat e tyre përkatëse.
- (l) Obligimet e Shtetit të parapara në garanci përbëjnë detyrimet ndërkombëtare të shtetit dhe janë miratuar në përputhje me dispozitat e Kushtetutës së Shtetit për marrëveshjet ndërkombëtare.
- (m) Borxhi i përfaqësuar nga Garantuesi raportohet tek institucionet relevante financiare ndërkombëtare dhe kontabilizohet në buxhetin e shtetit.

Së fundi, ju lutem vini re se Shteti ka miratuar një ligj që zgjeron disa privilegje, imunitete dhe përjashtime për Bankën pasi që Kosova është anëtare e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Sinqerisht i juaji,

Ministri i Drejtësisë
Republika e Kosovës

(Numri i operimit **44842**)
Versioni për ekzekutim

MARRËVESHJA PËR HUA

LINJA KREDITORE PËR FONDIN E SIGURIMEVE TË DEPOZITAVE NË KOSOVË

ndërmjet

FONDIT PËR SIGURIM TË DEPOZITAVE TË KOSOVËS

dhe

**BANKËS EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

Datë 19 Dhjetor 2013

TABELA E PËRMBAJTJES

NENI I - TERMAT DHE KUSHTET STANDARDE; PËRKUFIZIMET	1
Paragrafi 1.01. Përfshirja e Termave dhe Kushteve Standarde	1
Paragrafi 1.02. Përkufizimet.....	2
Paragrafi 1.03. Interpretimi	3
NENI II – KUSHTET KRYESORE TË HUASË	3
Paragrafi 2.01. Shuma dhe Valuta.....	3
Paragrafi 2.02. Kushtet tjera financiare të huasë.....	3
Paragrafi 2.03. Tërheqjet	4
NENI III – REALIZIMI I PROJEKTIT	5
Paragrafi 3.01. Marrëveshjet tjera afirmative të projektit	5
Paragrafi 3.02. Frekuenca e Raportimit dhe Dorëzimi i Kërkesave.....	5
NENI IV – MARRËVESHJET FINANCIARE DHE OPERACIONALE	6
Paragrafi 4.01. Të dhënat dhe Raportet Financiare	6
Paragrafi 4.02. Marrëveshjet financiare negative.....	7
Paragrafi 4.03. Marrëveshjet tjera financiare	8
Paragrafi 4.04. Drejtimi i biznesit dhe operacioneve	8
NENI V - PEZULLIMI, PËRSHPEJTIMI, ANULIMI.....	9
Paragrafi 5.01. Pezullimi	9
NENI VI - EFEKTIVITETI	9
Paragrafi 6.01. Kushtet Precedent për efektivitetin.....	9
Paragrafi 6.02. Opinioni Ligjore	9
Paragrafi 6.03. Përfundimi i afatit për bërjen efektiv.....	9
NENI VII - TË NDRYSHME	10
Paragrafi 7.01. Njoftime.....	10
SHTOJCA 1 - PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	1
SHTOJCA 2 - FORMA E OPINIONIT LIGJOR E HUAMARRËSIT	1
SHTOJCA 3 –FORMULARI I KËRKESËS PËR TËRHEQJE	1

MARRËVESHJA PËR HUA

MARRËVESHJA më datë 19 Dhjetor 2013 mes **FONDIT TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË KOSOVËS** (“Huamarrësi”) dhe **BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM** (“Banka”).

PARATHËNIE

NDONËSE, banka është themeluar për të siguruar financim për projekte të veçanta që të nxis tranzicionin drejt ekonomive të hapura dhe të orientuara kah tregu si dhe për të promovuar iniciativën private dhe sipërmarrëse në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore të cilat janë zotuar të zbatojnë parimet e demokracisë shumë partiake, pluralizmit dhe ekonomisë së tregut;

NDONËSE, Huamarrësi ka për qëllim të zbatojë projektin, siç përshkruhet në Shtojcën 1 e cila është dizajnuar të ndihmojë Huamarrësin duke i ofruar atij, likuiditet emergjent në rast se Huamarrësi detyrohet të kompensojë depozituesit e siguruar ose të paguajnë për depozitat të siguruara;

NDONËSE, Republika e Kosovës dhe Huamarrësi kanë kërkuar asistencë nga Banka për financimin e një pjese të projektit;

NDONËSE, në bazë të një marrëveshjeje garancie të kësaj date, në mes të Republikës së Kosovës si garantuese dhe Bankës (“Marrëveshja e garancisë”, siç përcaktohet në Termat dhe Kushtet Standarde), Garantuesi ka garantuar për obligimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

NDONËSE, Banka ka rënë dakord që, *ndër të tjera*, të sipërpërmendurit të jap hua Huamarrësit në shumën prej 10,000.000 euro, i cili nënshtrohet termave dhe kushteve të përcaktuara ose të referuara në këtë Marrëveshje.

SI REZULTAT, TANI, palët bien dakord si më poshtë:

NENI I - TERMAT DHE KUSHTET STANDARDE; PËRKUFIZIMET

Paragrafi 1.01. Përfshirja e Termave dhe Kushteve Standarde

Të gjitha dispozitat e Termave dhe Kushteve Standarde të Bankës së datës 1 dhjetor 2012 janë përfshirë dhe bërë të zbatueshme për këtë Marrëveshje me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishin plotësisht të parapara në këtë dokument, përveç se nuk vlen doracak i BERZH-it për Disbursim, (dispozita të tilla në tekstin e mëtejme quhen “Termat dhe Kushtet Standarde”).

Paragrafi 1.02. Përkufizimet

Të përdorura kudo në këtë Marrëveshje (duke përfshirë Parathënien dhe shtojcat), nëse nuk bëhet e ditur ndryshe ose konteksti e kërkon ndryshe, termat e përcaktuara në parathënie kanë kuptim përkatës dhënë atyre, termat e përcaktuara në kushtet dhe termat standarde kanë kuptimet përkatëse të dhënë atyre dhe termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“LFSD”	nënkupton Ligjin nr. 03/L-216 për Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë dhe Ligji nr. 4/L-133 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave të Institucioneve Financiare në Kosovë, e kjo e fundit mund të ndryshohet me kalimin e kohës.
“Ligji në fuqi për Depozita”	nënkupton LFSD-në dhe ligjin për bankat.
“Përfaqësuesi i autorizuar i huamarrësit”.	nënkupton përfaqësuesen Violeta Arifi Krasniqi
“BQK”	nënkupton Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.
“Periudha e zotimit”	nënkupton periudhën që fillon nga data efektive dhe përfundon në datën e fundit në dispozicion apo një datë e mëvonshme të cilën mund të vendosë Banka pas marrjes së kërkesës me shkrim nga Huamarrësi (kërkesa e të cilit duhet, kur ekziston Marrëveshja e Garancisë, të nënshkruhet nga garantuesi) dhe Banka e njofton menjëherë Huamarrësin për një datë të tillë të mëvonshme.
“Kërkesat e përcaktuara të performancës”	nënkupton kërkesat e Performancës prej 1 deri 8 dhe 10 (ose, sipas kontekstit, secila kërkesë e performancës) nga kërkesat e performancës të datës maj 2008 dhe që ndërlidhen me politikën mjedisore dhe sociale të Bankës të datës maj 2008.
“Viti fiskal”	nënkupton vitin fiskal të Huamarrësit që fillon më 1 janar të secilit vit.
“Depozituesit e siguruar”	ka kuptimin e termit të dhënë në LFSD.
“Depozitat e siguruar”	ka kuptimin e termit të dhënë në LFSD.
“Politika e Investimeve”	nënkupton politikat e investimit apo udhëzimet të miratuara zyrtarisht me kalimin e kohës nga ana e bordit menaxhues të Huamarrësit.

“Ligji për Bankat”	nënkupton Ligjin nr 04/L-093 për bankat, Institucionet mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare jo bankare, dhe e njëjta mund të ndryshohet me kalimin e kohës.
“Institucioni Financiar Anëtar”	nënkupton secilën bankë apo institucion tjetër financiar që është anëtar i skemës së sigurimit të depozitave të Huamarrësit dhe ka kuptimin e dhënë për “institucion financiar që merr depozita "në LFSD.
“Statutet”	nënkupton Statutet e Huamarrësit.

Paragrafi 1.03. Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, referenca në një nen, paragraf ose shtojcë të caktuar, përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, interpretohet si referencë ndaj atij neni, paragrafi ose shtojcë të caktuar, të kësaj Marrëveshjeje.

NENI II – KUSHTET KRYESORE TË HUASË

Paragrafi 2.01. Shuma dhe Valuta

Banka bie dakord t’i japë hua Huamarrësit, sipas kushteve dhe termave të përcaktuara ose të referuara në këtë Marrëveshje, shumën prej 10,000.000 eurove.

Paragrafi 2.02. Kushtet tjera financiare të huasë

- (a) Shuma minimale e tërheqjes do të jetë 500,000 euro.
- (b) Shuma minimale e parapagimit do të jetë 500,000 euro.
- (c) Shuma minimale e anulimit do të jetë 500,000 euro.
- (d) Datat e pagesës së interesit do të jenë [15 maj] dhe [15 nëntor] i secilit vit.
- (e) (1) Pas një tërheqje, secila shumë e huasë së papaguar do të paguhet nga Huamarrësi në mënyrë të barabartë (ose përafërsisht barabartë) në këste gjashtëmujore në secilën datë për pagesë të interesit të çdo viti, duke filluar nga data e pagesës së interesit të parë, që i bie dymbëdhjetë muaj pas tërheqjes së parë (“data e shlyerjes së huasë së parë”) dhe data e shlyerjes së huasë së fundit, që është datë fikse që i bie në datën e pagesës së interesit, më herët se 8 vjet pas tërheqjes së parë dhe pas përvjetorit të 12-të të kësaj Marrëveshjeje.

(2) Pavarësisht nga e mësipërmja, në rast se (i) Huamarrësi nuk tërheq të gjithë shumën e huasë para datës së parë të shlyerjes të përcaktuar në këtë paragraf 2.02. (e), dhe (ii) Banka zgjat datën e fundit në dispozicion të përcaktuar në paragrafin 2.02. (f) më poshtë në një datë e cila bie pas datës së shlyerjes së huasë së parë, atëherë shuma e secilës tërheqje të bërë në ose pas datës së shlyerjes së huasë së parë do të ndahet për shlyerje në sasi të barabarta për disa data të shlyerjes së huasë të cilat bien pas datës së tërheqjes (përshtatja e shumave të ndara me Bankën, aq sa është e nevojshme në mënyrë që të arrihet të gjitha numrat në secilën rast). Banka, me kalimin e kohës, duhet të njoftojë Huamarrësin për ndarje të tilla.

(f) Data e fundit në dispozicion do të jetë data që bie në një datë të caktuar që pasqyron përvjetorin e 7-të të kësaj Marrëveshjeje, ose në një datë të mëvonshme që Banka mund ta caktoj në diskrecion dhe ta njoftojë Huamarrësin dhe garantuesin.

(g) Norma e pagesës së zotimit do të jetë 0.5 % në vit.

(h) Norma e pagesës së interesit do të përcaktohet në Terma dhe Kushte Standarde për shumën e kryegjësë së huasë.

(i) Huua i nënshtrohet normës variable të interesit.

Paragrafi 2.03. Tërheqjet

(a) Shuma e disponueshme mund të tërhiqet vetëm për qëllimin e përcaktuar në Shtojcën 1 në bazë të:

(i) dukurisë së një “ngjarjes së siguar” siç përcaktohet në LFSD ose

(ii) miratimit nga bordi menaxhues të Huamarrësit në konsultim me BQK-në për përdorimin e fondeve të Huamarrësit dhe për transferimin e depozitave sa i përket Institucionit Financiar Anëtar nën administrimin zyrtar ose likuidimit në përputhje me Ligjin në fuqi për Depozita.

(b) Pagesa e interesit nga Huamarrësi do të bëhet në pajtim me paragrafin 3.05 (d) të Termave dhe Kushteve Standarde.

(c) Huamarrësi mund të kërkojë disbursim duke paraqitur pranë Bankës një kërkesë origjinale për disbursim të tillë, të nënshkruar nga ana e përfaqësuesit të autorizuar të Huamarrësit ose një person i caktuar nga Përfaqësuesi i autorizuar në formën e Shtojcës 3 dhe në përmbajtje që është e pranueshme për Bankën, të paktën 7 (shtatë) ditë pune para datës së propozuar së disbursimit në fjalë. Kërkesa e tillë, nëse Banka nuk bie dakord ndryshe, është e përvokueshme dhe detyruese për Huamarrësin. Disbursimi do të përdoret ekskluzivisht për qëllime të projektit dhe do të aplikohet në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

NENI III – REALIZIMI I PROJEKTIT

Paragrafi 3.01. Marrëveshjet tjera afirmative të projektit

Pa u kufizuar në përgjithësimin e paragrafëve 4.02 (a) , 4.04 (a) (iii), dhe 5.02 (c) (iii) të termave dhe kushteve standarde, Huamarrësi kryen aktivitetin e tij në përputhje me kërkesat e performancës 2 të BERZH-it.

Paragrafi 3.02. Frekuenca e Raportimit dhe Dorëzimi i Kërkesave

(a) Duke filluar nga data efektive, Huamarrësi do të dorëzojë raporte periodike për projektin të referuara në paragrafin 4.04 (a)(iv) të Kushteve dhe Termave Standarde për çdo gjashtë muaj, brenda 120 ditëve pas përfundimit të periudhës për të cilën u raportua, derisa të përfundojë projekti. Këto raporte do të përfshijnë karakteristikat e mëposhtme specifike:

- (1) Informatat e përgjithshme si më poshtë:
 - (A) ndryshimet në personelin kyç ose në bordin e Huamarrësit;
 - (B) çdo ndryshim të anëtarësisë të ndonjë institucioni Financiar Anëtar;
 - (C) Çështjet që mund të ndikojnë në kosto apo në zbatim të projektit; dhe të gjitha zhvillimet në lidhje me bashkë- sponsorët e mundshëm të projektit;
 - (D) çdo zhvillim apo aktivitet që ka gjasa të ndikojë në qëndrueshmërinë ekonomike të Huamarrësit ose ndonjë institucion Financiar Anëtar;
 - (E) çdo zhvillim apo aktivitet që ka gjasa të kërkojë nga huamarrësi për të paguar për secilin depozitues të çdo Institucioni Financiar anëtar;
 - (F) çdo ndryshim në Premium të pagueshëm për Huamarrësin nga ndonjë ose të gjitha Institucioneve Financiare Anëtare; dhe
 - (G) çdo ndryshim në politikat e investimeve.
- (2) Detajet e pagesave të bëra për çdo depozitues të secilit Institucion Financiar anëtar.
- (3) Një deklaratë të shkurtër për statusin e pajtueshmërisë me secilën prej ujdive të përfshira në Marrëveshjen për hua.
- (4) Një raport, me formë dhe fushëveprim të pranueshëm për BERZH-in, për zbatim të Kërkesave të performancës 2 të BERZH-it nga ana e Huamarrësit.

(b) Menjëherë pas çdo ndryshimi të termit ose çfarëdo dispozite në LFSD dhe Ligjin për Bankat.

(c) Në rast se Huamarrësi ka tërhequr ndonjë shumë sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do të dorëzojë raporte periodike në Bankë sipas kërkesës së Bankës nga

koha në kohë, në lidhje me përdorimin e fondeve të tërhequra në bazë të kësaj Marrëveshjeje, shumat që Huamarrësi ka paguar për deponuesit e siguruar në lidhje me secilën ngjarje të siguruar dhe shuma agregate e të gjitha depozitave të siguruara në lidhje me një ngjarje të siguruar të paguar dhe/ ose për t'u paguar, të gjitha në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën.

(d) Menjëherë pas shfaqjes së ndonjë incidenti që mund të ndikojë materialisht në pozitën financiare të Huamarrësit ose ndonjë zhvillim apo dukuri të ndonjë ngjarjeje që ka gjasa të kërkojë nga huamarrësi të paguaj secilin depozitues të siguruar të secilit Institucion Financiar anëtar, Huamarrësi do të njoftoj bankën përmes faksit, duke specifikuar natyrën e incidentit dhe hapat që huamarrësi është duke ndërmarrë për të korrigjuar këtë të fundit, nëse ka.

(e) Huamarrësi do t'i ofroj garantuesit një kopje origjinale të Marrëveshjes për hua.

(f) Huamarrësi do të njoftojë garantuesin për të gjitha kërkesat e bëra nga Huamarrësi tek Banka për disbursime, plotësimeve, mohime dhe pëlqime.

(g) Obligimet e Huamarrësit për raportim të përcaktuara në paragrafin 3.02 do t'i nënshtrohen obligimeve të konfidencialitetit që është detyruese për Huamarrësin qoftë me ligj ose me marrëveshje me BQK-në.

NENI IV – MARRËVESHJET FINANCIARE DHE OPERACIONALE

Paragrafi 4.01. Të dhënat dhe Raportet Financiare

(a) Huamarrësi do të ketë procedura, mirëmbaj regjistrime dhe llogari të cilat reflektojnë mjaftueshëm, në përputhje me standardet e kontabilitetit të pranuar ndërkombëtarisht të aplikuar në mënyrë konistente, operacionet dhe gjendjen financiare të Huamarrësit dhe filialeve të tij, (në rast se Huamarrësit i është lejuar të ketë filialet e tij në pajtim me paragrafin 4.02 (b) (2), si dhe të monitoroj dhe regjistroj në mënyrë adekuate progresin e projektit (duke përfshirë kostot dhe përfitimet që do të rrjedhin nga ajo).

(b) Huamarrësi do të:

(1) të ketë të dhënat e veta, llogaritë dhe pasqyrat financiare (duke përfshirë bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrën e ndryshimeve në pozicionin financiar, përfshirë edhe shënimet e bashkangjitura), të dhënat, llogaritë dhe pasqyrat financiare të filialeve të tij (në rast se Huamarrësi lejohet të ketë filialet në pajtim me paragrafin 4.02 (b) (2), për secilin vit fiskal duhet audituar nga auditorë të pavarur, të pranueshëm për Bankën, në përputhje me parimet dhe standardet e auditimit të pranuar ndërkombëtarisht;

(2) ti paraqesë Bankës sapo t'i ketë në dispozicion, por për çdo rast jo më vonë se pesë muaj pas përfundimit të secilit vit fiskal:

(A) kopje të vërtetuara të pasqyrave të audituara financiare për vitin përkatës fiskal;

(B) Raporti i tillë i auditimit nga auditorët me fushëveprim të tillë dhe në detaje të tilla të cilin Banka mund ta kërkojë si të arsyeshme; dhe

(C) informacion mbi portofolion e fondeve në dispozicion të Huamarrësit në rast se Huamarrësi detyrohet të paguaj depozituesit të ndonjë Institucioni Financiar anëtar.

dhe

(3) t'i japë informacione tjera bankës në lidhje me të dhënat e tilla, llogaritë dhe pasqyrat financiare, të audituara, me kërkesë të arsyeshme nga Banka me kalimin e kohës.

Paragrafi 4.02. Marrëveshjet financiare negative

(a) Huamarrësi, përveç kur Banka nuk bie dakord ndryshe, nuk do të marrë ndonjë nga veprimet e mëposhtme dhe do t'i sigurojë Bankës të gjitha informacionet e tilla që Banka mund ti kërkojë si të arsyeshme:

(1) të hyjë në çfarëdo marrëveshje ose aranzhim për të garantuar ose në ndonjë mënyrë apo edhe ndonjë kusht të obligohet për të gjithë ose një pjesë të ndonjë detyrimi financiar apo detyrimi tjetër të një personi tjetër, duke përfshirë çdo filial apo institucion vartës ose dhe Institucion Financiar anëtar ndryshe nga ajo që kërkohet në pajtim me LFSD në rastin kur institucioni financiar Anëtar nuk ka mundësi të kryej detyrimet financiare ndaj depozituesve të siguruar;

(2) të shesë, japë me qira ose të heq nga përdorimi ndonjë pasuri që është e nevojshme për kryerjen efikase të operacioneve të tij apo largimi i të cilave mund të paragjykojë aftësinë e tij për të kryer të në mënyrë të pranueshme ndonjë prej obligimeve që dalin nga kjo Marrëveshje;

(3) të shesë, japë me qira ose të heq nga përdorimi ndonjë pasuri që është e nevojshme për kryerjen efikase të operacioneve të tij apo largimi i të cilave mund të paragjykojë aftësinë e tij për të kryer të në mënyrë të pranueshme ndonjë prej obligimeve që dalin nga kjo Marrëveshje;

(4) të ndër marrë ose të lejojë çfarëdo shkrirje firmash, konsolidim apo riorganizim,

(5) të ulë tarifat e pagueshme për Huamarrësin nga ndonjë ose të gjitha institucionet financiare anëtare përveç atyre që përcaktohen me LFSD;

(6) të ndryshojë nivelin e mbulimit të sigurimit për depozit në çdo shumë mbi 5,000 euro; ose

(7) të investojë në pasuritë tjera të Huamarrësit përveç atyre të përshkruara me LFSD.

(b) Huamarrësi nuk do të ndërmarrë, nëse nuk e informon Bankën së paku 30 ditë më herët, cilindo nga veprimet e mëposhtme dhe do t'i ofrojë Bankës të gjithë informacionin siç mund ta kërkojë Banka në mënyrë të arsyeshme:

(1) të hyjë në çfarëdo kontrate menaxhimi apo marrëveshje të ngjashme me anë të së cilës bizneset apo operacionet e saj menaxhohen nga cilido person tjetër, duke përfshirë cilindo ent ose filial përveç: aktivitetet e transferimeve të ndërmarra në pajtim me ALDI, të tilla si shërbimet e pagesës nga agjenti, shërbimet e menaxhimit të pasurive, shërbimet lidhur me lëshimin e obligacioneve dhe funksioneve të kontabilitetit që aktualisht jepen. ; ose

(2) nga cilado filialë.

(c) Huamarrësi nuk do të bëjë ose nuk do të lejojë që të ekzistojnë hua apo paradhënie, ose depozita (me përjashtim të depozitave në rrjedhën e zakonshme të biznesit me bankat që kanë reputacion) me persona tjerë ose investime në cilindo person, duke përfshirë çdo filial ose ent ("Investime"), me kusht që, sidoqoftë, Huamarrësi të ketë liri të bëjë ndonjë investim në përputhje me Politikën e Investimeve (që mund të ndryshojë me kalimin e kohës) dhe t'i ofroj bankës një kopje.

(d) Huamarrësi deklaron dhe garanton se ndërmarrjet e mësipërme të Huamarrësit janë plotësisht në përputhje me ligjet e Kosovës dhe në veçanti me LFSD.

Paragrafi 4.03. Marrëveshjet tjera financiare

Pa kufizuar përgjithësimin e paragrafit 4.02, Huamarrësi para secilës tërheqje do të mbaje, në çdo kohe, raport minimal prej 5% të likuiditetit për depozita të siguruar ku "Likuiditeti" nënkupton totalin e të gjitha fondeve të Huamarrësit, të gjitha fondet në dispozicion të Huamarrësit, në pajtim me lehtësimet në hua në gatishmëri mes dhe institucioneve financiare ndërkombëtare apo bankat zhvillimore.

Paragrafi 4.04. Drejtimi i biznesit dhe operacioneve

Huamarrësi, përveç kur Banka bie dakord ndryshe, pajtohet të:

(a) drejtoje biznesin dhe operacionet në përputhje me LFSD, standardet dhe praktikat e shëndosha administrative, financiare të njohura ndërkombëtarisht, si dhe standardeve dhe praktikave tjera duke i dhënë konsideratën e duhur për të gjitha politikat kryesore operuese.

(b) ndërmarrë menjëherë të gjitha veprimet brenda aftësive të tij për të ruajtur ekzistencën e tij ligjore, të vazhdoje operacionet e tij dhe të sigurojë, të mbaje dhe të rimarrë të gjitha të drejtat, pasuritë, fuqitë, privilegjet dhe franshizat që janë të nevojshme për të drejtuar biznesin e tij, duke përfshirë edhe vazhdimin e projektit; dhe

(c) njoftojë menjëherë Bankën për çdo propozim për të ndryshuar, pezulluar ose shfuqizuar çfarëdo dispozite të statutit dhe t'i japë Bankës një mundësi adekuate të komentojë një propozim të tillë para se të ndërmarrë ndonjë veprim.

NENI V - PEZULLIMI, PËRSHPEJTIMI, ANULIMI

Paragrafi 5.01. Pezullimi

Pikat në vijim janë përcaktuar saktë për qëllimet e paragrafit 7.01(a)(xiv) të Kushteve dhe Termave standarde:

- (a) korniza ligjore dhe rregullative në fuqi për sektorin e sigurimit të depozitave në territorin e Garantuesit do të ndryshohen, pezullohen, abrogohen, shfuqizohen ose mohohen, në mënyrë tjetër nga ajo që është aprovuar nga banka me shkrim.
- (b) Statutet do të ndryshohen, pezullohen, abrogohen, shfuqizohen ose mohohen në mënyrë tjetër nga ajo që është aprovuar nga banka me shkrim; ose
- (c) Huaja nuk është përdorur në pajtim me Shtojcën 1 dhe parimet e praktikave më të mira ndërkombëtare që kanë të bëjnë me skemat e sigurimit të depozitave.

NENI VI - EFEKTIVITETI

Paragrafi 6.01. Kushtet Precedent për efektivitetin

Pikat në vijim janë specifikuar për qëllimet e paragrafit 9.02(c) të kushteve dhe termave standarde si kushte suplementare për efektivitetin e kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes së garancisë:

- (a) Marrëveshja e garancisë do të ratifikohet nga Kuvendi i Kosovës dhe kështu do të ketë fuqi dhe efekt të plotë;

Paragrafi 6.02. Opinioni Ligjore

- (a) Për qëllimet e paragrafit 9.03(b) të Kushteve dhe Termave standarde, opinioni ose opinionet ligjore të këshilltarit do të jepen në emër të Huamarrësit kryesisht në formë të shtojcës 2.
- (b) Për qëllimet e paragrafit 9.03(b) të Kushteve dhe Termave standarde, opinioni ose opinionet ligjore të këshilltarit do të jepen në emër të Garantuesit nga Ministri i Drejtësisë.

Paragrafi 6.03. Përfundimi i afatit për bërjen efektiv

Data 180 ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje është specifikuar për qëllimet e paragrafit 9.04 të kushteve dhe termave standarde.

NENI VII - TË NDRYSHME

Paragrafi 7.01. Njoftime

Adresat në vijim janë specifikuar për qëllimet e paragrafit 10.01 të kushteve dhe termave standarde:

Për Huamarrësin:

Fondi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës, Rruga Garibaldi 11/3, 10000
Prishtinë, Republika e Kosovës

Në vëmendje të: Violeta Arifi Krasniqi

Faksi: +381 38 243 763

Për Bankën:

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
Londër EC2A 2JN
Mbretëria e Bashkuar

Në vëmendje të: Departamenti i Administratës dhe Operimeve

Faksi: +44-20-7338-6100

NE PRANI TË DËSHMITARËVE, palët në këtë Marrëveshje duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, kanë bere që kjo Marrëveshje të nënshkruhet ne katër kopje në Prishtinë, Kosovë, në ditën dhe vitin e shkruar me sipër.

FONDI I SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË KOSOVËS

Nga: _____
Emri:
Titulli:

**BANKA EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

Nga: _____
Emri:
Titulli:

SHTOJCA 1 - PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1. Qëllimi i projektit është ti ofroj Huamarrësit likuiditet dhe të ndihmojë Huamarrësin të kryej obligimet e tij ligjore
 - (i) dukuria e “ngjarjes së siguruar” siç përcaktohet tek LFSD sipas së cilit Huamarrësi duhet të kompensoj Depozuesit e siguruar në pajtim me LFSD ose
 - (ii) miratimi nga bordi menaxhues të Huamarrësit në konsultim me BQK-në për përdorimin e fondeve të Huamarrësit dhe për transferimin e depozitave sa i përket Institucionit Financiar Anëtar nën administrimin zyrtar ose likuidimit në përputhje me Ligjin në fuqi për Depozita.
2. Projekti përbëhet nga pjesët si në vijim, që i nënshtrohen modifikimeve për të cilat Banka dhe Huamarrësi mund të bien dakord me kalimin e kohës:

Pjesa A: 10,000,000 Euro linjë kreditore Standby (në gatishmëri)
3. Projekti pritet të përfundojë deri në dhjetor 2025.

SCHEDULE 2 – FORM OF BORROWER LEGAL OPINION

[të vendoset logoja zyrtare e huamarrësit]

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
Londër EC2A 2JN
Mbretëria e Bashkuar

[Data]

Zonja dhe zotërinj:

Re: Opinioni ligjor në Marrëveshjen për Hua ndërmjet [shëno emrin e plotë , ligjor të Huamarrësit ashtu siç është në Marrëveshjen për hua] dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në lidhje me huanë për projektin [shëno emrin e plotë të projektit, siç paraqitet tek Marrëveshja për hua].

Më [shëno datën e Marrëveshjes për Hua], Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”) përmbylli një marrëveshje për hua (“Marrëveshja për hua”) me [shëno emrin e plotë, ligjor të Huamarrësit ashtu siç paraqitet në Marrëveshjen për Hua] (“Huamarrësi”) për të ndihmuar në financimin e projektit [shëno emrin e projektit ashtu siç paraqitet në Marrëveshjen për Hua] (“Projekti”) , duke dhënë një hua në shumën prej [shëno shumën dhe valutën monetare të huasë ashtu siç paraqitet në Marrëveshjen për Hua].

Në të njëjtën ditë, për Bankën që ka hyrë në Marrëveshjen për Hua, [Shëno emrin e plotë, sovran të anëtarit të BERZH-it ashtu siç paraqitet në Marrëveshjen e Garancisë] (“Garantuesi”) përmbylli një marrëveshje garancie (“Marrëveshja e garancisë”) me Bankën.

Termet e përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë të përdorur në këtë dokument, janë të tilla si përcaktohen në Marrëveshjen e Huasë.

Pursuant to Section 9.02(a) of the Standard Terms and Conditions, the Loan Agreement Në bazë të paragrafit 9.02 (a) të Kushteve dhe Termave Standarde, Marrëveshjen e Huasë dhe marrëveshja për Garancinë nuk do të hyjë në fuqi derisa dëshmitë, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, i ofrohen Bankës që realizimi Marrëveshjes së Huasë në emër të Huamarrësit është autorizuar ose ratifikuar nga të gjitha veprimet të nevojshme korporatave, qeveritare, parlamentare. Në bazë të paragrafit 9.03 (a) të Kushteve dhe Termave Standarde, si pjesë e dëshmive, Huamarrësi është i detyruar të sigurojë, ose ti ofrojë Bankës një opinion ose opinione (në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën), të këshilltarit të pranueshëm për Bankën, që ndër të tjera tregon se Marrëveshja e huasë është autorizuar ose ratifikuar si dhe ekzekutuar dhe dorëzuar në emër të Huamarrësit dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjërish detyruar për Huamarrësin, i zbatueshëm në përputhje me kushtet e saj.

Në bazë të paragrafit [6.02] të Marrëveshjes së Huasë, opinioni i tillë ligjor jepet në emër të Huamarrësit nga *[shëno titullin e zyrtarit që jep opinionin]*.

Në cilësinë time si *[shëno titullin e zyrtarit që jep opinionin]* i Huamarrësit, kam inspektuar dhe kam nënshkruar një kopje të Marrëveshjes për Hua dhe gjithë dokumentacionit tjetër përkatës si dhe kam shqyrtuar ligje të tilla, statute, dokumente dhe çështje të tjera, dhe kam bërë kërkime të tjera të tilla që unë i konsideroj të nevojshme ose të përshtatshme për të dhënë këtë opinion. Bazuar në atë që u tha më sipër, unë jam i mendimit dhe deklaroj, përkatësisht, se:

(a) Huamarrësi është themeluar nga *[Cito ligjet, statutet, dekretet përkatëse, ose vendimin e garantuesit që ka themeluar Huamarrësin]*⁵⁷ dhe është valid sipas ligjeve të garantuesit me fuqi të marrë detyrimet sipas Marrëveshjes së Huasë.

(b) Më *[shëno datën e vendimit të organit qeverisës të Huamarrësit i cili miraton marrëveshjen e huasë]*, *[shëno emrin e plotë ligjor të organit qeverisës të Huamarrësit të autorizuar që të miratojë marrëveshjen e huasë]* të Huamarrësit, në pajtim për kompetencat e tij bazuar në *[Cito dispozitën përkatëse të statutit themelues apo statutet e Huamarrësit të cilët e autorizojnë organin qeverisës të Huamarrësit që të miratojë marrëveshjen e huasë]*⁵⁸, ka vendosur që:

(1) Teksti i huasë miratohet nga Huamarrësi;

(2) Përfundimi i Marrëveshjes së Huasë autorizohet nga Huamarrësi; dhe

(3) *[shëno emrin dhe titullin e përfaqësuesit të Huamarrësit të cilët kanë realizuar marrëveshjen e huasë]* autorizohet të nënshkruajë dhe të dorëzojë Marrëveshjen e Huasë në emër të Huamarrësit.

(c) të bashkëngjitet përkthimi i duhur dhe i saktë në gjuhën angleze të *[Cito vendimin e organit qeverisës të Huamarrësit i cili miraton marrëveshjen e huasë]*⁵⁹ Autorizon dhe konfirmon çështjet e referuara në paragrafin e mësipërm dhe që zgjidhja e tillë është në fuqi dhe efekt të plotë dhe se nuk është ndryshuar.

(d) Në *[Shëno vendndodhjen e nënshkrimit të Marrëveshjes së Huasë]* më *[shëno datën e Marrëveshjes së Huasë]*, Marrëveshja e huasë është nënshkruar dhe dorëzuar nga *[shëno emrin dhe titullin e përfaqësuesit të Huamarrësit të cilët kanë realizuar Marrëveshjen për hua]* në emër të Huamarrësit në pajtim me *[Cito vendimin e organit qeverisës të Huamarrësit i cili miraton marrëveshjen e huasë]*.

Bazuar në më sipër, konkluzioni im se Marrëveshja e huasë është autorizuar ose ratifikuar si dhe realizuar dhe dorëzuar në emër të Huamarrësit dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjërish detyrues për Huamarrësit, të zbatueshëm në përputhje me kushtet.

⁵⁷ Bashkangjitur duhet të jenë dëshmi të dokumentuara, të përkthyer në gjuhën angleze, të themelimit të Huamarrësit

⁵⁸ Bashkangjitur duhet të jenë Dëshmi të dokumentuara, të përkthyer në gjuhën angleze të autoritetit të organit të tillë qeverisës i cili miraton marrëveshjen e huasë

⁵⁹ Bashkangjitur duhet të vendimi përkatës, i përkthyer në gjuhën angleze

Bashkëngjitur është përkthimi i duhur dhe i saktë në gjuhën angleze të [*Cito vendimin e organit qeverisës të Huamarrësit i cili miraton marrëveshjen e huasë*]⁶⁰ Autorizon dhe konfirmon çështjet e referuara në paragrafin e mësipërm dhe që zgjidhja e tillë është në fuqi dhe efekt të plotë dhe se nuk është ndryshuar.

Sinqerisht i juaji,

[*Shëno emrin dhe titullin e zyrtarit i cili jep këtë opinion*]

[*Listoni dokumentet e bashkëngjitura*]

⁶⁰ Bashkëngjitur duhet të vendimi përkatës, i përkthyer në gjuhën angleze.

SHTOJCA 3 –FORMULARI I KËRKESËS PËR TËRHEQJE

Për: Bankën Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim, _____⁶¹
One Exchange Square,
Londër EC2A 2JN
Mbretëria e Bashkuar.
Për vëmendjen e: Njësisë Administrative Operuese.

Re: Marrëveshja e Huasë së datës _____ mes Bankës Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim dhe Fondit të Sigurimit të Depozitave në Kosovë (Huamarrësi).

Valuta dhe shuma e huasë: 10 MILLION EURO
Numri i operimit: 45446

Numri i aplikacionit: _____

Nëpërmjet kësaj kërkojmë disbursimin e shumës së cekur në llogarinë e specifikuar më poshtë në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Huasë të përmendur më lart:

Valuta e Huasë: EURO

Shuma e kërkuar⁶²: EURO _____

Valuta e pagesës: EURO _____

Data e vlerës⁶³: _____

Udhëzimet për pagesë (Detajet e bankës):

Emri i llogarisë së personit për t'u paguar:

Numri i llogarisë së personit për t'u paguar:

Emri i Bankës së personit për t'u paguar:

Adresa e Banës së personit për t'u paguar:

Referenca e pagesës (nëse ka)⁶⁴: _____

⁶¹ Shëno datën e aplikimit.

⁶² Shëno shumën në fjalë dhe numra.

⁶³ Data kur llogaria e BERZH-it do të debitohet.

⁶⁴ Nëse nuk ka, BERZH do të specifikon emrin e Huamarrësit.

Me anë të kësaj vërtetojmë dhe pasqyrojmë se:

- (a) dukuria e “ngjarjes së siguruar” ka ndodhur ashtu siç përcaktohet në LFSD përmes së cilës Huamarrësi duhet të kompensojë Depozituesit e siguruar në pajtim me LFSD [dhe/ose]

Bordi menaxhues i Huamarrësit në konsultim me BQK-në ka miratuar përdorimin e fondeve të Huamarrësit dhe transferimin e depozitave sa i përket Institucionit Financiar Anëtar nën administrimin zyrtar ose likuidimit dhe Huamarrësi duhet të transferoj fonde në një bankë tjetër në përputhje me Ligjin në fuqi për Depozita,

Për Institucionin Financiar Anëtar:

Emri: _____

Data: _____

- (b) shumat që Huamarrësi duhet të mbulojë janë përlogaritur të jenë:

⁶⁵ _____;

- (d) ne kemi/nuk kemi⁶⁶ kërkuar disbursim më herët për ngjarjet e përshkruara në (a) më sipër;

- (e) të ardhurat e këtij disbursimi do të vlejnjë për projektin në përputhje me kushtet e marrëveshjes së huasë;

- (f) Huamarrësi është në përputhje me detyrimet e tij siç përcaktohet në Marrëveshjen e Huasë; dhe

- (g) se nuk ka ndodhur asnjë ngjarje e cila mund të ndikojë materialisht dhe negativisht në gjendjen financiare të Huamarrësit ose aftësinë e tij për të kryer ndonjë prej detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes së Huasë.

Termat e përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë kanë të njëjtin kuptim edhe këtu.

Sinqerisht, i juaji

Nga dhe në emër të Fondit për Sigurimin e Depozitave të Kosovës.

Emri dhe Nënshkrimi:

Titulli

Përmbyllje: - Numri total i fletëve:: _____

⁶⁵ Shëno shumën në fjalë dhe numra..

⁶⁶ Fshij atë që nuk vlen.

